



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

**Në çështjen juridike të :**

**AC-I-15-0223-A0002**

**A.B. Gjilan.**

***Paditësi/Parashtruesi***

**Kundër:**

***E paditura/Ankuesja***

**Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rr. "Agim Ramadani" nr. 23, Prishtinë.**

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami Gjyqtar Kryesues, Sabri Halili dhe Hajrie Shala, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e ankuesve, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të DHPGJS-së, C-IV-13-2830, i datës 08 tetor 2015, në seancën vendimmarrëse të mbajtur më 12 shtator 2019, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditësit hedhet poshtë si e pa pranueshme.**
- 2. Ankesa e të paditurës, AKP-së, aprovohet si e bazuar .**
- 3. Anullohet Aktgjykimi i Gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-IV-13-2830 i datës 08 tetor 2015.**
- 4. Lënda, dërgohet për rigjykim në shkallë të parë të DHPGJS-së.**
- 5. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

## **Rrethanat procedurale dhe gjendja faktike**

Paditësi, A.B. , ka parashtruar kërkesë në Dhomën e Posaçme më 05 nëntor 2013, për rishqyrtimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit ( më tutje AL) GJI037-0035 të datës 02 tetor 2013 kërkesa e tij për kompensimin e tri pagave të papaguara në shumë prej 750.00 euro si dhe shpërblimin për ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës, në shumë prej 1.750,00 euro N.H.N.I "MB" e cila kërkesë ishte refuzuar.

Si provë kërkesës i ka bashkangjitur Vendimin e atakuar GJI037-0035 të datës 02 tetor 2013, njoftimin e AKP-së të datës 09 maj 2008 dhe kopjen e librezës së punës.

DHPGJS me aktvendimin C-IV-13-2830 të datës 28 prill 2014 kërkesën dhe dokumentet përcjellëse i janë dërguar të paditurës dhe AKP-së për të dhënë mbrojtjen.

AKP-ja me 19 qershor 2014 ka parashtruar mbrojtje në padi duke e kundërshtuar ankesën si të pa pranueshme dhe të pa bazuar. Sipas AKP-së sa i përket tri pagave të pa paguara kërkesa e njëjte është parashkruar pasi që nuk është paraqitur brenda afatit prej 3 viteve nga koha kur punëdhënësi nuk ka përmbushur obligimin që rrjedh nga marrëdhënia e punës ndërsa sa i përket kërkesës lidhur me dëmshpërblimin për ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës AKP-ja pohon se neni 10.1.6.2 i shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 i jep të drejtë vetëm atyre punëtorëve që janë shkarkuar nga puna si pasojë e një veprimi të ndërmarrë nga AKP-ja.

Paditësi me 04 gusht 2014 ka parashtruar përgjigje ndaj mbrojtjes së AKP-së. E paditura më 09 shtator 2014 ka parashtruar kundërpërgjigje.

Më 08 tetor 2015 Gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara të DHPGJS-së ka marrë Aktgjykimin C-IV-13-2830 me të cilin aprovon si të bazuar kërkesën për shpërblim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të Kontratës së punës, ndryshon vendimin e Autoritetit të Likuidimit nr. GJI037-0035 të datës 02 tetor 2013 dhe obligon të paditurën AL-AKP-së që ankuesit A.B. nga Gjilani, ti paguaj

dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1,750.00 në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi, me arsyetimin se me veprimin e AKP-së, shitjen e asetëve të ndërmarrjes i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës, ky është një veprim që AKP e ka ndërmarr në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve që ka në bazë të ligjit dhe nga kjo e drejta për kompensimin për ndërprerjen e parakohshme të marrëdhënies së punës është e bazuar. Ndërsa kërkesa për kompensimin e tri pagave refuzohet si e pa bazuar me arsyetimin se ankuesi me asnjë prove nuk ka dëshmuar se cilët muaj dhe cilit vit i takojnë pagat të cilat i kërkon.

Më 19 tetor 2015, **ankuesi A0001 A.B.** , ka parashtruar një parashtresë . Me këtë parashtresë ai ka kërkuar që në afat sa më të shkurtër ti paguhen mjetet në vlerën e pranuar nga ana e Aktgjykimit Gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të DHPGJS-së, C-IV-13-2830, i datës 08 tetor 2015.

AKP-ja parashtresën e paditësit të lartcekur e ka pranuar më 26 prill 2018 dhe ndaj të njëjtës ka parashtruar përgjigje në ankesë, duke pohuar se e kundërshton në tërësi ankesën e paditësit dhe duke propozuar që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pa bazuar në ligj.

Më 20 tetor 2015, **ankuesja A0002 AKP-ja**, (më tutje Ankuesja) ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-13-2830 të datës 08 tetor 2015 (më tutje Aktgjykimi i ankimuar ). Sipas ankueses neni 40.1.6.2 i shtojcës se Ligjit 04/L-034 u njeh të drejtën e kompensimit për ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës vetëm atyre punëtorëve që janë pushuar nga puna (kanë pasur humbje/dëm financiar) si pasojë e një veprimi të ndërmarrë nga AKP-ja që duhet të dallohen nga punëtorët që nuk janë pushuar nga puna si pasojë e një veprimi të ndërmarrë nga AKP-ja por si pasojë e një veprimi të ndërmarrë nga drejtuesit e NSH-së. Sipas ankueses ekzistojnë dy kritere për të gëzuar të drejtën e kompensimit për ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës 1. Pushimi nga puna (humbja financiare) dhe 2. Duhet të jetë pasojë e një veprimi të ndërmarrë nga AKP-ja ose në lidhje me këtë të fundit. Po ashtu ankuesja pohoi se kërkuar nuk ishte punëtor i

ndërmarrjes në momentin e privatizimit dhe se privatizimi i NSH nuk i ka shkaktuar asnjë dëm financiar. Për më tepër në shkresa të lënës nuk asnjë provë me të cilat provohet stazhi i punës dhe lartësia e pagës së punëtorit. Andaj Kolegjit të Apelit i propozon që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe të vërtetohet Vendimin e AL si dhe të rimbursojë taksën gjyqësore të paguar nga Ankuesja.

Paditësi, ankesën e ankuesit të lartcekur e ka pranuar më 30 prill 2018 dhe ndaj të njëjtës ka parashtruar përgjigje në ankesë, duke pohuar se e kundërshton në tërësi ankesën e AKP-së. Përgjigjes i bashkëngjit, Njoftimin nr. 285 të datës 17/06/2011 dhe nr. 0428/2011 të datës 14/03/2011, Njoftimin nr. 0400/IN të datës 08/03/2011, padi parashtruar në DHPGJS- të datës 17/03/2011, si dhe Vendimin për pushim pa pagesë të datës 02/12/2003

### **Arsyetimi ligjor**

Parashtresa e paditësit A0001 **A.B.** hedhet poshtë dhe ankesa e ankueses A0002 AKP-së, aprovohet si e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Shtojcës së Ligjit të Republikës së Kosovës nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.

Kolegji i Apelit konstaton se Kolegji i Specializuar vendosi në mënyrë të gabuar mbi meritat e ankesës, pa e konsideruar në mënyrë të plotë, nëse ankesa i plotëson kriteret e pranueshmërisë.

Në bazë të nenit 31.4 të LDHP paditësi/ankuesi i cili kërkon kompensim monetar është i detyruar të paraqesë një listë të dëmeve që përcaktojnë natyrën e humbjes ose dëmit, shumën e parave të kërkuara për secilën lloj humbjeje ose dëmtimi dhe listën e provave, që do të ofrohen në mbështetje të atij lloji të humbjes ose dëmtimi.

Neni 36 paragrafi 3 i LDHP-së parashikon që padia/ ankesa është e pranueshme vetëm nëse është paraqitur në përputhje me paragrafin 2 të nenit 36 të LDHP-së dhe në përputhje me kërkesat e nenit 33 të LDHP-së. Më tej, neni 36 paragrafi 3 autorizon Kolegjin e Specializuar që ta refuzojë padinë / ankesën si të papranueshme nëse përcakton që kërkesat e parashtruara në nenin 35 nuk plotësohen dhe të specifikojë bazën ligjore për një refuzim të tillë (shih Nenin 36 të LDHP-së). Neni 36 fjalë e dytë, kërkon nga Kolegji i Specializuar që t'i lëshojë një urdhër paditësit / ankuesit për korrigjimin e gabimeve dhe prapë të parashtrojë një kërkesë / ankesë të pranueshme.

Në rastin në fjalë, ankuesi ka paraqitur një ankesë në Dhomën e Posaçme për shpërblimin për shkak të ndërprerjes së parakohshme të punësimit, pa e treguar shumën e pagës mujore si dhe përvojën e punës në (stazhin) në NSH. Këto arsye ishin pohuar edhe në Vendimin e AL si dhe në përgjigje ndaj ankesës së parashtruar nga AKP-ja.

Parashtruesi i kërkesës për shpërblimin për ndërprerje të Kontratës ka dështuar që para Gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara por edhe para Kolegjit të Apelit përmes ankesës së ushtruar të dëshmojë me prova se sa ishte paga mujore e tij si dhe përvoja e tij e punës në NSH. Ai vetëm ka specifikuar shumën prej 1.750.00 € si shumë që NSH-ja duhet të paguaj si shpërblim për ndërprerje të parakohshme të punës.

Kolegji i Apelit konsideron, Aktgjykimi i Gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të DHPGJS-së, C-IV-13-2830, i datës 08 tetor 2015, duke aprovuar kërkesën pa e specifikuar pagën mujore si dhe përvojën e punës, ka shkelur dispozitat e nenit 36 nënpika 2.5 të Ligjit 06/L-086.

Ndërsa si i përket kohës së ndërprerje se marrëdhënie së punës, Kolegji i Apelit pajtohet në tërësi me konstatimin e Gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara se Njoftimi i datës 09 maj 2008 e cila gjendet në shkresat e lëndës, vërtetohet momentin kur punëtorit i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Mbi bazën e këtyre arsyeve, Kolegji i Apelit konstaton se ankesa është e bazuar dhe rrjedhimisht Aktgjykimi i ankimuar duhet të anulohet dhe gështja të kthehet në rigjykim.

Në rastin konkret prova determinante për të pretenduar këtë të drejtë janë stazhi dhe shuma e pagës mujore.

Lidhur me Ankesën A0001 Kolegji konstaton se e njëjta është një parashtresë me të cilin punëtori kërkon pagimin e shumës prej 1.750,00 euro të aprovuara në Aktgjykimin e ankimuar . Si e tillë ajo është pa objekt kontesti andaj duhet hedhur poshtë si të pa pranueshme.

I mbetet Kolegjit të Specializuar të vendos lidhur me rimbursimin e taksës gjyqësore

Me sa u tha më sipër e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Taksat gjyqësore:**

Ankuesit nuk ngarkohet me taksë gjyqësore. Ai tashmë ka paguar taksën gjyqësore.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, më 12 shtator 2019.

Ilmi Bajrami,

Gjytqar Kryesues i Kolegjit të Apelit

---

## **URDHËR PËR ZYREN E REGJISTRIMIT**

Luteni ta dërgoni këtë Aktgjykim tek:

- Ankuesi
- tek e paditura
- Gjyqtarit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së në lëndën C-IV-13-2830

Ilmi Bajrami,

Gjytqar Kryesues i Kolegjit të Apelit